Në bazë të kreut III të Nenit 15 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës'' Kuvendi i FGJK-së, aprovoi këtë:

RREGULLORE

MBI PUNËN E BORDIT TË FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS SË KOSOVËS (FGJK)

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Me këtë rregullore të punës rregullohet mënyra e punës së Bordit të Kuvendit të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë Bordit të FGJK-së).

Neni 2.

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përgatiten, caktohen dhe mbahen mbledhjet e Bordti të FGJK-së.

Neni 3.

Bordi i FGJK-së përbëhet nga 9 anëtar:

- Kryetari,
- Sekretari i përgjithshëm i cili është këshillues pa të drejtë vote,
- Kryetari dhe 5 (pesës) anëtarët zgjedhen nga Kuvendi, ndërsa 2 (dy) anëtarët i emron Kryetari, me kooptim dhe një (1) anëtar Kyretari i Komisionit të Sportistëve zgjedhet nga votimi i sportistëve.
- Në përbërje të Bordit duhet të jenë të përfaqësuar femrat me 30%.

Neni 4.

Mandati i anëtarëve të Bordit të FGJK-së zgjatë 4 (katër) vite.
Mandati i anëtarëve të Bordit të FGJK-së mund të pushoi edhe para skadimit të mandatit në këto raste:

- Ndryshon ose e humbë shtetësinë,
- Jep dorëheqje,
- Shkarkohet, (nëse nuk merr pjesë më shumë se 3 herë në mbledhjet e bordit, etj)
- I ndërpritet anëtarsia në klubin e tij,
- Me vdekje,
- Paraqiten kushte të tilla shkaku i të cilave nuk mundet me kryer punën,
- Në rastet tjera të parapara me Ligj dhe Statut.

- Bordi i FGJK-së mund të nxjerr vendim mbi fillimin e inicimit të shkarkimit të antëtarit të Bordit. Ditën që nxirret një vendim i tillë, anëtari i Bordit të FGJK-së nuk mund të marr pjesë në mbledhjet e Bordit të FGJK-së.
- Gjithashtu nëse një anëtarë është edhe në Bord të ndonjë Federate, shoqate, etj, tjetër, ai/ajo nuk mund të zgjedhet anëtarë/e e Bordit të FGJK-së.

II. FUSHËVEPRIMI

Neni 5.

Fushëveprimi i Bordit të FGJK-së është:

- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit,
- Vendos për projektet të cilat i përkrah, financon Organizata,
- Mund të propozon kandidatët për të gjitha funksionet të cilat i zgjedh Kuvendi,
- Nxjerr sistemin e garave,
- Cakton udhëheqësit e seksioneve të FGJK-së,
- Zgjedhë komisionet për kryerjen e detyrave të caktuara,
- Zbaton politikën zhvillimore të sportit të Gjimnastikës,
- Zbaton Statutin dhe aktet tjera të cilat i bjen Kuvendi,
- Vendos për miratimin e akteve të përgjithshme të FGJK-së, miratimi i të cilave nuk është në kompetenca të Kuvendit,
- Miraton propozimin për marrjen e vendimit për paraqitjen e kandidaturës për organizimin e Kampionateve Botërore dhe Europiane, Ballkanike dhe të garave tjera Ndërkombëtare,
- Jep propozime për pranimin e anëtarëve të rinj,
- Vendos për mënyrën e fitimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare në kuadër të programit dhe planit financiar,
- Propozon përbërjen, kriteret, planin dhe afatin e garave.
- Zgjedhe Sekretarin e përgjithshem,
- Zgjedhe Selektorin e Kombëtares, Përfaqësuesës,
- Miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare dhe ia dërgon Kuvendit për miratim,
- Vendos për miratimin e rregulloreve apo të ndryshimeve të rregulloreve, miratimi i të cilave nuk është në kompetenca të Kuvendit,
- Vendos për marrje me veprimtari ekonomike,
- Harmonizon planin financiar gjatë vitit në pajtim me rrethanat e ndryshuara,
- Miraton planin vjetor të punës,
- Kryen punë dhe veprimtari tjera të cilat ia beson Kuvendi ose nevojat që i kërkon veprimtaria e FGJK-së.

III. MBLEDHJET E BORDIT TË FGJK-së,

Neni 6.

Bordi i FGJK-së në mbledhjet e veta nxjerr vendime, konkluzione, qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme, aprovon rregulloret të reja dhe të përditësuara nga Komisioni për hartimin e rregulloreve, siç parashehet në statutin e FGJK-së, neni 29, paragrafi 1.8.

Neni 7.

Mbledhjet e Bordit të FGJK-së mbahen sipas nevojës, por më së paku njëherë në muaj.

Neni 8.

Në mbledhjet e Bordit mbahet procesverbali apo edhe mund të incizohet.
Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, kronologjike, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai. Procesverbalin e nënshkruan procesmbajtësi dhe Kryetari.

IV . PËRGADITJA DHE THIRRJA E MBLEDHJEVE TË BORDIT TË FGJK-së

Neni 9.

Përgatitjen e mbledhjeve të Bordit e organizon Kryetari i Bordit.
Në përgatitjen e mbledhjes së Bordit janë të obliguar të marrin pjesë edhe Nënkryetarët e Sekretari si dhe persona tjerë që i fton Kryetari.

Neni 10.

Propozimin e rendit të ditës për mbledhjet e Bordit e përcakton Kryetari, sipas iniciativës së vet apo sipas propozimit të anëtarëve tjerë të Bordit.

Neni 11.

Materiali për mbledhje të Bordit të FGJK-së përmban propozime, vendime, konkluzione dhe masa të tjera me arsyetimin e duhur, si dhe procesverbali nga mbledhja e kaluar e Bordit.
Materiali për mbledhje dërgohet së bashku me ftesë për mbledhje.

Neni 12.

Mbledhjen e Bordit e thërret Kryetari i Bordit. Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjen e thërret njëri nga dy nënkryetarët apo njëri nga anëtarët që e autorizon Kryetari.

Neni 13.

Për mbledhje të Bordit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët. Ftesa për mbledhje bëhet në formë me shkrim, së paku 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
Ftesa mund të dërgohet edhe në mënyrë elektronike me kusht që anëtari ta konfirmoi pranimin e saj, si dhe me anë të telefonit.

Neni 14.

Prania në mbledhje është e obligueshme. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që ta njoftoi Kryetarin.

IV. PUNA NË MBLEDHJET E BORDIT

Neni 15.

Bordi i FGJK-së, punon dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.

Neni 16.

Me punën e Bordit udhëheq Kryetari, në rast të mungesës së Kryetarit, mbledhjen e udhëheq njëri Nënkryetar apo Sekretari. Në raste të jashtëzakonshme, mbledhjen mund ta udhëheq personi i autorizuar.

Neni 17.

Kryetari udhëheq me punën e Bordit, iu jep dhe merr fjalën, propozon rendin e ditës, kujdeset për rendin dhe zbatimin e Rregullorës së punës, tërheq vërejtjen për tejkalimin e kohës së diskutimit dhe daljes nga rendi i ditës.

Neni 18.

Për secilën pikë të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë dhe sipas radhitjes së miratuar.

Neni 19

Bordi i FGJK-së mund të vendos sipas propozimit të Kryetarit që koha e diskutimit të kufizohet.
Anëtari i Bordit ka të drejtë në replikë, nëse drejtpërdrejtë është përmendur apo në një mënyrë tjetër është kundërshtuar qëndrimi i tij, por ajo replikë nuk mund të jetë më e gjatë se 5 minuta**.**

Neni 20.

Çdo vendim i Bordit të FGJK-së, e obligon Kryetarin për ndërmarrjen e masave për zbatimin e tij.

Neni 21.

Bordi i FGJK-së në mbledhjet e veta veçanërisht i kushton kujdes zbatimit të vendimeve të veta, konkluzioneve dhe masave të tjera që i ka nxjerr në mbledhjen e mëparme.

V. VENDIMET DHE VOTIMI

Neni 22.

Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Bordit 50% +1 . Para votimit për çdo pikë të rendit të ditës mund të kërkohet që të konstatohet kuorumi. Votimi bëhet në mënyrë të hapur me ngritjen e dorës. Në raste të veçanta, Bordi i FGJK-së mund të nxjerr vendim për votim të fshehtë.
Në situata të jashtëzakonshme, mbledhjet e Bordit të FGJK-së mund të mbahen edhe përmes platformave elektronike dhe rrjeteve sociale, skype, viber, teams, facebook, sms etj.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23.

Punët administrativo-teknike për nevojat e Bordit dhe nevojat për punën e anëtarëve të saj i bën Sekretari me administratën e organizatës.

Neni 24.

Kjo Rregullore u miratua nga ana e Kuvendit i FGJK me datë 18/04/2026, i cili gjithashtu ka të drejtën ta bëjë ndryshimin dhe plotësimin e saj.

Kryetari i FGJK-ës:
Shkumbin Maqastena

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS • KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION • FGJK - KGF

Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

Prishtinë: 18/04/2026